



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 1103 Prot.

Fier, më 22.10. 2024

**SHPALLJE Nr. 2**

**E VENDEVE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT  
PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
(IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER**

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, shpall vendet e lira të punës për punonjës në njësinë e shërbimit psiko-social (**psikolog/punonjës-social**) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

**I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psiko-social**

**A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos ketë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

**B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:**

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse;
3. Njohuri bazë në kompjuter;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi,certifikata);
5. Aftësi komunikuese dhe punë në grup.

**II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

**A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae), sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjeko-ligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);

4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi(për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme);
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetëdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar ( detyrueshme).

**14. Kualifikimi dhe vlerësimi i kandidatëve do të bazohet edhe në kreun VII, pika 4 të Urdhërit nr. 313 datë 20.10.2020, të ndryshuar.**

**B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier brenda afatit 22.10.2024- 27.10.2024.**

- III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social do të kryhet nga komisioni në datën 28.10.2024 -29.10.2024.
- IV. Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në faqen zyrtare të DRAP Fier në datë 29.10.2024.
- V. Ankimimet brenda datës 30.10.2024.
- VI. Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 30. 10.2024.
- VII. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjekë procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020 i ndryshuar.
- VIII. Vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse bashkëlidhur.



## LISTA E VENDEVE TË LIRA VAKANT PËR PUNONJËS TË SHPS

Dt.22.10.2024

Nr.	DRAP	ZVA	Shkolla ku do të ketë emërimin	Shkollat plotësuese	Psikolog/P	L. Lindje
1	Fier	Fier	Janag Kilica	Janag Kilica	P.Social	Me afat
2	Fier	Fier	Janag Kilica	Janag Kilica	Psikolog	Me afat
3	Fier	Fier	Andon Profka	Lili Stavre, Ymer Xhafa	P.Social	Me afat
4	Fier	Fier	Ramiz Ceka	Riza Braka	Psikolog	Me afat
5	Fier	Fier	Avdi Metaj	Agur Merkaj, Lëvizja Demokratike	Psikolog	Me afat
6	Fier	Fier	Trifon Prifti	Miti Stroni, 5 Dëshmorët	P.Social	Me afat
7	Fier	Fier	Dino Ismaili	Dino Ismaili, Xhevit Fetahu	Psikolog	Me afat
8	Fier	Fier	Mustafa Hoxha	Xhevit Fetahu	P.Social	Me afat
9	Fier	Finiq-Dropull	SHMB Dervişan	SHMB Bularat	Psikolog	Me afat
10	Fier	Finiq-Dropull	SHMB "L'efter Talo" Livadhja	Shkolla 9-vjeçare Mesopotam, Shkolla 9-vjeçare Finiq	Psikolog	Me afat
11	Fier	Gjirrokaster-Libohovë	Avni Rustemi	11 shkurti, Petro Poga	Psikolog	Me afat
12	Fier	Mallakaster	Gjimmazi "Hajredin Fratari"Fratar	SHMB "Dervish Hekali" Hekal	P.social	Me afat
13	Fier	Mallakaster	Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja"Ballsh	"Ramiz Aranitasi" Aranitas	P.Social	Me afat
14	Fier	Mallakaster	Shkolla 9-vjeçare "Gjokë Doçi"Symizë	"7 Dëshmoret"Nimesh, "9 Dëshmoret"Bejar	Psikolog	Me afat
15	Fier	Patos	Meleg Gosnishi	Meleg Gosnishi	P.Social	Me afat
16	Fier	Patos	Muhamet Shehu	Sadush Dervishi	Psikolog	Me afat
17	Fier	Permet-Kelecyre	9-vj Meleg Gosnishi Permet	Shkolla 9-vj "Koco Shukallari" Iliar-Munushtr	Psikolog	Me afat
18	Fier	Permet-Kelecyre	SHMB "Lumo Pavari" Suke	SHMB "Zyrihana Xhako" Ballaban, shkolla 1 Maji Piskove	P.social	Me afat
19	Fier	Roskovec	SHMB - "Didin Bishani" Kurjan	Jashar Muhameti, Jorgo Sopiku, Ali Sollaku	P.Social	Me afat
20	Fier	Roskovec	9-vjeçare "5 Dëshmorët" Suk 1	Ajet Toska, 7 Dëshmoret, Zylyftar Veleshnja	P.Social	Me afat
21	Fier	Roskovec	9-vjeçare "Alush Grepeka" Roskovec	Rexhep Kothere	P.Social	Me afat
22	Fier	Sarandë-Konispol-Dë	"Bido Sejko " Konispol	"Bido Sejko "	Psikolog	Me afat
23	Fier	Sarandë-Konispol-Dë	Hasan Tahsini	Hasan Tahsini	Psikolog	Me afat
24	Fier	Vlorë-Himarë	Ali Demi	Ali Demi	P.Social	Me afat
25	Fier	Selenice	Qani Nuredini	Laze Nuro, Hamdi Rapi, Hajredin Begari, Dëshmorë e Peshkëpi	Psikolog	Me afat
26	Fier	Selenice	Egerem Begiri	Ali Asllamin, Todi Koceli	P.Social	Me afat



27	Fier	Selenice	Filo Ramadani	Mynyr Xhindi, Sadik Zotaj	Psikolog	Me afat
28	Fier	Tepelenë-Memaliaj	'Adem Alushi' Lulëzim	'Ormën Selami' Qesarat	P.Social	Me afat
29	Fier	Tepelenë-Memaliaj	'Xhevit Çela' Izvor	'Xhevit Çela'	P.Social	Me afat
30	Fier	Tepelenë-Memaliaj	'Nimete Progonati' Memaliaj	'Sali Nivica' Memaliaj	Psikolog	Me afat
31	Fier	Tepelenë-Memaliaj	'Avni Rustemi' Tepelenë	'Avni Rustemi'	Psikolog	Me afat
32	Fier	Tepelenë-Memaliaj	'Memo Nexhipi' Dukaj	'Nevro Selimi' Hormovë	P.Social	Me afat
33	Fier	Vlore-Himare	9-vjecare'Jani Minga"	Jani Minga"	P.social	Me afat
34	Fier	Vlore-Himare	9-vjecare"Rilindja"	Rilindja"	P.social	Me afat
35	Fier	Vlore-Himare	9-vjecare" Marigo Posio"	9-vjecare" 4 Heronjte"	P.social	Me afat
36	Fier	Vlore-Himare	9-vjecare" Pano Nikolla Meniko"	Gjinnazi" Spiro Gjilnuri", SHMB"Hyssen Cino", SHMB "Mem	Psikolog	Me afat
37	Fier	Vlore-Himare	SHMB"Qazim Pali", Borsh	9-vjecare"Lukove", SHMB "Hasan Mehili", Dukat, 9-vjecare "	Psikolog	Me afat
38	Fier	Sarandë-K onispol-De	"Antoni Athanas"		Psikolog	Me afat
39	Fier	Vlore-Himare	9-vjecare "Ismail Qemali"	"Ismail Qemali"	Psikolog	Deri 05.01.2024
40	Fier	Fier	Vasil Sota	Halit Gremi, Petro Baze	P.Social	Deri 05.01.2024

